



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1488/7 prot

Datë 29/08/2023

**V E N D I M**  
**Nr. 836/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29/08/2023 me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-73401-06-22-2023, me objekt “*Blerje pleh organik, humus trofe dhe pleh kimik*”, me fond limit 8,080,000 (*tetë milion e tetëdhjetë mijë*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.07.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-73401-06-22-2023, me objekt “*Blerje pleh organik, humus trofe dhe pleh kimik*”, me fond limit 8,080,000 (*tetë milion e tetëdhjetë mijë*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK  
*Adresa: Ura e Gjolës, Budull, Bubq, Durrës.*

**Autoriteti Kontraktor:**

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.  
*Adresa: Rruga “Xhezmi Delli” Godina nr. 20, Tiranë.*

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.06.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-73401-06-22-2023, me objekt “Blerje pleh organik, humus trofe dhe pleh kimik”, me fond limit 8,080,000 (tetë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.07.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Në datën 29.06.2023, operatori ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK ka paraqitur ankesë, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 906/14 prot, datë 04.07.2023, protokolluar me tonën me nr. 1488/2 prot, datë 07.07.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 906/14 prot, datë 04.07.2023, protokolluar me tonën me nr. 1488/2 prot, datë 07.07.2023, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK ku ka vendosur që të pranojë pjesërisht ankesën, si më poshtë vijon:

*“III. Në lidhje me kundërshtimin e paraqitur nga OE “AME 2020” SHPK sa i takon kriterit të pasjes në pronësi ose me qira të mjeteve motorrike si dhe kërkesës për paraqitjen e certifikatës së pronësisë së mjeteve, sqarojmë se: Nisur nga natyra e mallit që do të prokurohet si dhe nga afati i lëvrimit të përcaktuar në shtojcën 6, konkludohet se numri i automjeteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor nuk është në përputhje me sasinë/volumin e mallit që do të prokurohet. Konkretisht kërkesa për disponimin i 4 kamionçinave nga ana e operatorëve ekonomik, respektivisht 2 me kapacitete mbajtës mbi 1.3 ton dhe 2 me kapacitet mbajtës nën 1 ton, nuk është në proporcion me natyrën e kontratës. Ky kriter duhet të rishikohet nga ana e Autoritetit Kontraktor duke ulur numrin e mjeteve që duhet të disponojnë operatorët ekonomik.*

*Sa i takon kërkesës për disponimin e një kamioni me vinç me kapacitete mbajtës deri në 3 ton dhe të një piruni, vlerësojmë se kjo kërkesë nuk është në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e mallit dhe për këtë arsye duhet të rishikohet nga ana e Autoritetit Kontraktor.*

*Kjo pike ndryshohet si më poshtë:*

*2.3.6 Të ketë në pronësi ose me qira mjetet për transportin e mallit objekt-prokurimi si më poshtë:*

- Kamionçina, 2 (dy) copë , me kapacitet mbajtës mbi 1.3 ton, në pronësi ose me qira.*
- Kamion me vinç, 1 (një) copë , me kapacitet mbajtës jo më pak se 3 ton, në pronësi ose me qira.*

*Të pajisura me dokumentet si më poshtë:*

- *Certifikatë pronësie ose Leje qarkullimi ose kontrate qiraje e lidhur tek noteri, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- *Certifikatën e kontrollit teknik*
- *Siguracionin e mjetit*

*Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose leje qarkullimi ose kopje të noterizuar (shitblerje ose kontrata dhurimi).*

*Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar) ose leje qarkullimi. Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).*

*Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme ) me foto.*

*Për mjetet me qira duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme) dhe foto. Duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

*Ky kriter do të përmbushet nga Operatori Ekonomik me anë të formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.*

**IV. Në lidhje me kundërshtimin e paraqitur nga OE “AME 2020” SHPK në lidhje me përmendjen e markës si dhe përcaktimin e specifikimeve teknike të produktit që do të prokurohet, sqarojmë se: Nga shqyrtimi i Shtojcës 7 pjesë e DST-së së kësaj procedure, rezulton se në shënimet përfundimtare është përcaktuar se citojmë “Në të gjitha rastet kur përdoret emri ose marka, njihet njëvlefshmëria apo barazvlefshmëria, ose ekuivalent”.**

*Në rastin konkret Autoriteti Kontraktor ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në pikën 4 të nenti 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” duke përdorur termin “ekuivalent”.*

*Për sa më lart Shtojcën 5 e DST-ve ndryshon si më poshtë vijon:*

*- Torfë importi (substrat me mikro element ushqyes)*

1. *Të jetë ambalazhuar dhe shoqëruar me fletë udhëzuesin e përdorimit përkatës.*
2. *Të ketë të shkruar mbi ambalazh emërtimin, muajin dhe vitin e skadencës, sasinë e ambalazhuar, elementet përbërës, vendin e prodhimit.*
4. *Ambalazhi të siguroj ruajtjen në kushte optimale dhe depërtimin e lagështirës.*
5. *Specifikimet teknike dhe disa tregues të përbërjes së torfes i paraqesim më poshtë:*

1. *Produkti: Trofë importuese,*
2. *Përmbajtja e lagështisë: 40-60%*
3. *Acideti PH (CaCl): 5,5-6,5*
4. *Përmbajtje NPK: 14*
5. *Komponentët plotësues: Argjilë Radigen*
6. *Agjentët e lagështirës: Flba Zorb*

7. *Ambalazhuar në thasë me peshën: 70 litra*

- **Torfë (e thjeshtë)**

1. *Përmbajtja e lagështisë: 40 %*
2. *Të jetë i pastër nga mbeturinat.*
3. *Të jetë e frezuar dhe e situr.*
4. *Të jetë e ambalazhuar në thasë 50 kg.*

- **Plehu organi**

1. *Të jetë pleh organik prodhuar nga stallat e bagëtive të imta.*
2. *Të jetë pleh organik i dekompozuar mbi dy vjet dhe i mbuluar me dhe.*
3. *Të jetë i pastër nga mbeturina (copa drurësh, degësh, gurë, etj).*
4. *Të jetë ambalazhuar në thasë: 25 k*

- **Humus pylli**

1. *Të jetë grumbulluar në pyje fletorë nën shtresën e lëgushës 10 cm.*
2. *Të jetë i pastër nga mbeturinat (copa drurësh, degësh, gurë, etj).*
3. *Të jetë i situr.*
4. *Të jetë ambalazhuar në thasë 25 kg*

- **Plehra kimike**

1. *Të jenë të ambalazuara dhe të shoqëruar me fletë udhëzuesin e përdorimit përkatës.*
2. *Të kenë të shkruar mbi ambalazh emërtimin e plehut kimik, muajin dhe vitin e skadencës, sasinë e plehut kimik të ambalazhuar, elementet përbërës, vendin e prodhimit.*
3. *Plehrat kimike të jenë të ambalazhuar sipas llojit dhe përbërjes e gjendjes;*  
- *për plehrat kimik në gjendje kokrrizore, të jetë në ambalazhe plastike ose letër kundra ujit*  
- *për plehrat kimike në gjendje pluhur, të jenë në ambalazh letre kundra ujit*
4. *Ambalazhi të siguroj ruajtjen në kushte optimale dhe depërtimin e lagështirës.*
5. *Specifikimet teknike dhe disa tregues të përbërjes së pesticideve i paraqesim më poshtë:*

**Produkti: Ushqyes Kristalor**

<i>Produkti</i>	<i>N</i>	<i>P<sub>2</sub>O<sub>5</sub></i>	<i>K<sub>2</sub>O</i>	<i>MgO</i>	<i>SO<sub>3</sub></i>	<i>B</i>	<i>Zn*</i>	<i>Mn*</i>	<i>Fe</i>	<i>Cu*</i>	<i>Mo</i>
<b><i>Ushqyes Kristalor</i></b>	12	12	17	2	20	0,02	0,01	-	-	-	-

**Produkti: NPK**

<i>Produkti</i>	<i>N</i>	<i>P<sub>2</sub>O<sub>5</sub></i>	<i>K<sub>2</sub>O</i>
<b><i>NPK</i></b>	15	15	15

**Produkti: Nitrat Amoni**

<i>Përmbajtja</i>	<i>Rezultati</i>	<i>Metoda</i>
<b><i>Përmbajtja e azotit</i></b>	34.63%	<i>EC 2003/2003-M2</i>

Lagështira	0.39%	AOAC 950.1-2005
Granulometria 1.0-4.0 mm	99.20%	EC 2003/2003M5

**Produkti: DAP**

Produkti	N	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	K <sub>2</sub> O
DAP (NH <sub>4</sub> ) <sub>2</sub> HPO <sub>4</sub> (s)	18	46	0

*Për sa argumentuam më sipër, komisioni i shqyrtimit të ankesës konkludon se ankesa e paraqitur nga shoqëria “AME 2020” SHPK, do të merret pjesërisht parasysht.”.*

II.6. Në datën 18.07.2023, me anë të shkresës nr.1488/3 prot, datë 18.07.2023, Komisioni i Prokurimit Publik vë në dijeni autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik ankimues, se për shkaqe të nevojshme për verifikim në përputhje me përcaktimet e nenit 115, pika 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.7. Duke qenë se një nga pretendimet e operatorit ekonomik “AME 2020” SHPK e parashtruar në ankesë lidhet me kriterin kualifikues për paraqitjen e dokumentit “Certifikatë e Regjistrimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, KPP me qëllim gjykimin e ankesës dhe shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave, me anë të shkresës nr. 1488/4 prot., datë 18.07.2023 i kërkoi Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural informacion të hollësishëm mbi cilët subjekt bie detyrimi për pajisje me Certifikatën e Regjistrimit mbështetur në ligjit nr. 17/2020 “Për produktet plehëruese”.

II.8. Në mungesë të informacionit të kërkuar nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, KPP me qëllim gjykimin e ankesës dhe shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave, me anë të shkresës nr. 1488/5 prot., datë 22.08.2023, i rikërkoi Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural një informacion të hollësishëm, se për cilat subjekte është detyrim ligjor pajisja me Certifikatën e Regjistrimit mbështetur në ligjit nr. 17/2020 “Për produktet plehëruese”, nëse përfshihet në këtë kategori prodhuesi, importuesi dhe tregtuesi (rishitësi) i autorizuar i torfës profesionale, si dhe cilat janë kategoritë e produkteve për të cilat kërkohet ky certifikim, a kërkohet ky certifikim për trofën profesionale.

II.9. Me shkresën nr. 4029/1 prot, datë 25.08.2023 me objekt: “Kthim-përgjigje”, protokolluar me tonën nr. 1488/6 prot, datë 28.08.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si më poshtë:

*“Në përgjigje të shkresës suaj, me Nr. 1488/4 prot., datë 18.7.2023, dhe shkresës vijuese me nr. 1488/5 prot. datë 22.8.2023, sqarojmë si më poshtë:*

*- Ligji Nr. 17/2020 “Për produktet plehëruese” përcakton që të gjitha produktet plehëruese që prodhohen, importohen, tregtohen dhe përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit. Klasifikimi i produkteve plehëruese për të cilat është*

detyrim regjistrimi përcaktohet në nenin 5 të Ligjit Nr. 17/2020, ndërsa kërkesat për regjistrim parashikohen në nenin 7 të tij. Vetëm produktet plehëruese të regjistruara lejohet të tregtohen, importohen, eksportohen ose përdoren. Torfa profesionale është produkt plehërues dhe duhet të regjistrohet sipas procedurës së parashikuar në ligj.

- Lidhur me procedurën e regjistrimit, neni 8 i Ligjit Nr. 17/2020, parashikon dokumentacionin dhe procedurën që ndiqet për regjistrim. Në nenin 4 pika 2 jepet përkufizimi i aplikantit: “Aplikanti, është personi apo subjekti që prodhon një produkt plehërues, që ia beson prodhimin e tij një të treti ose një personi të emëruar nga prodhuesi, si përfaqësues i autorizuar i tij, i cili paraqet kërkesë për regjistrimin e produktit plehërues”. Më tej, shkronja a) pika 1 e nenit 8 parashikon që kërkesa e aplikantit është pjesë e dokumentacionit.

- Neni 12 i ligjit përcakton se një kopje origjinale e dokumentit të regjistrimit i dorëzohet aplikantit dhe përmban certifikatën e regjistrimit dhe etiketën. Të dhënat që përmban certifikata (ndër të tjera emri i aplikantit dhe prodhuesi), dhe etiketa (ku ndër te tjera vendoset dhe importuesi) janë po ashtu të parashikuara në nenin 12 të ligjit.”.

### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, lidhur me mbi disponimin e 4 (katër) kamionçinave, lidhur me kërkesën e dubluar për disponimin e 1 (një) kamioni me vinç me kapacitet mbajtës jo më pak se 3 (tre) ton dhe njëkohësisht të 1 (një) piruni, si dhe lidhur me heqjen e emërtimeve “Substrati: ProfiMix 2b” dhe “Nitrofoska” në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 906/14 prot, datë 04.07.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “A.M.E” SHPK, nëpërmjet së cilës ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës si më poshtë vijon:

*“III. Në lidhje me kundërshtimin e paraqitur nga OE “AME 2020” SHPK sa i takon kriterit të pasjes në pronësi ose me qira të mjeteve motorrike si dhe kërkesës për paraqitjen e certifikatës së pronësisë së mjeteve, sqarojmë se: Nisur nga natyra e mallit që do të prokurohet si dhe nga afati i lëvrimin të përcaktuar në shtojcën 6, konkludohet se numri i automjeteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor nuk është në përputhje me sasinë/volumin e mallit që do të prokurohet. Konkretisht kërkesa për disponimin i 4 kamionçinave nga ana e*

operatorëve ekonomik, repektivisht 2 me kapacitete mbajtës mbi 1.3 ton dhe 2 me kapacitet mbajtës nën 1 ton, nuk është në proporcion me natyrën e kontratës. Ky kriter duhet të rishikohet nga ana e Autoritetit Kontraktor duke ulur numrin e mjeteve që duhet të disponojnë operatorët ekonomik.

Sa i takon kërkesës për disponimin e një kamioni me vinç me kapacitete mbajtës der në 3 ton dhe të një piruni, vlerësojmë se kjo kërkesë nuk është në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e mallit dhe për këtë arsye duhet të rishikohet nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Kjo pike ndryshohet si më poshtë:

2.3.6 Të ketë në pronësi ose me qera mjetet për transportin e mallit objekt prokurimi si më poshtë:

- Kamionçina, 2 (dy) copë , **me kapacitet mbajtës mbi 1.3 ton**, në pronësi ose me qira.
- Kamion me vinç, 1 (një) copë , me kapacitet mbajtës jo më pak se 3 ton, në pronësi ose me qira.

Të pajisura me dokumentet si më poshtë:

- Certifikatë pronësie ose Leje qarkullimi ose kontrate qiraje e lidhur tek noteri, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Certifikatën e kontrollit teknik
- Siguracionin e mjetit

Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose leje qarkullimi ose kopje të noterizuar (shitblerje ose kontrata dhurimi).

Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar) ose leje qarkullimi. Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).

Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme ) me foto.

Për mjetet me qira duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme) dhe foto. Duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Ky kriter do të përmbushet nga Operatori Ekonomik me anë të formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

**IV. Në lidhje me kundërshtimin e paraqitur nga OE “AME 2020” SHPK në lidhje me përmendjen e markës si dhe përcaktimin e specifikimeve teknike të produktit që do të prokurohet, sqarojmë se: Nga shqyrtimi i Shtojcës 7 pjesë e DST-së së kësaj procedure, rezulton se në shënimet përfundimtare është përcaktuar se citojmë “Në të gjitha rastet kur përdoret emri ose marka, njihet njëvlefshmëria apo barazvlefshmëria, ose ekuivalent”.**



Në rastin konkret Autoriteti Kontraktor ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në pikën 4 të nenti 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” duke përdorur termin “ekuivalent”.

Për sa më lart Shtojcën 5 e DST-ve ndryshon si më poshtë vijon:

- **Torfë importi** (substrat me mikro element ushqyes)

1. Të jetë ambalazhuar dhe shoqëruar me fletë udhëzuesin e përdorimit përkatës.
2. Të ketë të shkruar mbi ambalazh emërtimin, muajin dhe vitin e skadencës, sasinë e ambalazhuar, elementet përbërës, vendin e prodhimit.
4. Ambalazhi të siguroj ruajtjen në kushte optimale dhe depërtimin e lagështirës.
5. Specifikimet teknike dhe disa tregues të përbërjes së torfes i paraqesim më poshtë:

8. Produkti: Trofë importuese,
9. Përmbajtja e lagështisë: 40-60%
10. Acideti PH (CaCl): 5,5-6,5
11. Përmbajtje NPK: 14
12. Komponentët plotësues: Argjilë Radigen
13. Agjentët e lagështirës: Flba Zorb
14. Ambalazhuar në thasë me peshën: 70 litra

- **Torfë (e thjeshtë)**

5. Përmbajtja e lagështisë: 40 %
6. Të jetë i pastër nga mbeturinat.
7. Të jetë e frezuar dhe e situar.
8. Të jetë e ambalazhuar në thasë 50 kg.

- **Plehu organi**

1. Të jetë pleh organik prodhuar nga stallat e bagëtive të imta.
2. Të jetë pleh organik i dekompozuar mbi dy vjet dhe i mbuluar me dhe.
3. Të jetë i pastër nga mbeturina (copa drurësh, degësh, gurë, etj).
4. Të jetë ambalazhuar në thasë: 25 k

- **Humus pylli**

1. Të jetë grumbulluar në pyje fletorë nën shtresën e lëgushës 10 cm.
2. Të jetë i pastër nga mbeturinat (copa drurësh, degësh, gurë, etj).
3. Të jetë i situar.
4. Të jetë ambalazhuar në thasë 25 kg

- **Plehra kimike**

1. Të jenë të ambalazuara dhe të shoqëruar me fletë udhëzuesin e përdorimit përkatës.
2. Të kenë të shkruar mbi ambalazh emërtimin e plehut kimik, muajin dhe vitin e skadencës, sasinë e plehut kimik të ambalazhuar, elementet përbërës, vendin e prodhimit.
3. Plehurat kimike të jenë të ambalazhuar sipas llojit dhe përbërjes e gjendjes;  
- për plehurat kimik në gjendje kokrrizore, të jetë në ambalazhe plastike ose letër kundra ujit

- për plehrat kimike në gjendje pluhur, të jenë në ambalazh letre kundra ujit

4. Ambalazhi të siguroj ruajtjen në kushte optimale dhe depërtimin e lagështirës.

5. Specifikimet teknike dhe disa tregues të përbërjes së pesticideve i paraqesim më poshtë:

**Produkti: Ushqyes Kristalor**

Produkti	N	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	K <sub>2</sub> O	MgO	SO <sub>3</sub>	B	Zn*	Mn*	Fe	Cu*	Mo
Ushqyes Kristalor	12	12	17	2	20	0,02	0,01	-	-	-	-

**Produkti: NPK**

Produkti	N	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	K <sub>2</sub> O
NPK	15	15	15

**Produkti: Nitrat Amoni**

Përmbajtja	Rezultati	Metoda
Përmbajtja e azotit	34.63%	EC 2003/2003-M2
Lagështira	0.39%	AOAC 950.1-2005
Granulometria 1.0-4.0 mm	99.20%	EC 2003/2003M5

**Produkti: DAP**

Produkti	N	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	K <sub>2</sub> O
DAP (NH <sub>4</sub> ) <sub>2</sub> HPO <sub>4</sub> (s)	18	46	0

*Për sa argumentuam më sipër, komisioni i shqyrtimit të ankesës konkludon se ankesa e paraqitur nga shoqëria “AME 2020” SHPK, do të merret pjesërisht parasysh.”.*

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”.

Për këtë arsye, Komisioni Prokurimit Publik do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 1488 protokollin, me datë 29.06.2023 e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, lidhur me modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1 Në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 7 “FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

“2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë prodhues ose furnizues/tregtues i autorizuar i torfës profesionale. Për kete duhet te paraqese:

a) Licencë prodhimi ose kontratë furnizimi me torfë profesionale

b) Certifikatë e Regjistrimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe duhet të përmbushë karakteristikat e mëposhtme:

- Pamja e jashtme (gjendja fizike dhe ngjyra) Përzierje e ngurtë, me ngjyrë biond dhe të errët.

- *Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lëndë organike (MO), 80%, Ushqyes Makro dhe Mikroushqyes 1.5kg/m<sup>3</sup>, Karbonat kalciumi (CaCO<sub>3</sub>)3-3.5 kg/m<sup>3</sup>.  
Ose*
- *Pamja e jashtme (gjendja fizike dhe ngjyra): Përzierje e ngurtë me ngjyrë kafe të errët.*
- *Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lëndë organike (MO): 80% ; Ushqyes makro dhe mikroushqyes: 1.5kg/m<sup>3</sup> : Karbonat kalciumi (CaCO<sub>3</sub>) : 2-2.5 kg/m<sup>3</sup>.”.*

III.2.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

*“Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, licencat e mësipërme që kërkohen janë të lëshuara nga QKL dhe licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit, secila prej tyre është e përfshirë në fushën e gjelbërimit dhe kërkimi i tyre që të zotërohen nga OE pjesëmarrës në procedurë tregon kualifikim dhe cilësi.”.*

III.2.3. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 906/14 prot, datë 04.07.2023, drejtuar ankimuesit ka argumentuar si në vijim:

*“Sa i takon kundërshtimit të paraqitur nga OE “AME 2020” SHPK të kriterit të përcaktuar në shkronjën “b”, pika 2.3.3 të kapacitetit teknik, konkretisht **Certifikatë e rregjistrimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit**, sqarojmë se:*

*Torfa është produkt plehërues organik, që rrjedhë nga materialet organike me origjinë shtazore ose bimore, të përbërë nga përbërësit organikë, në të cilët elementet kryesore të fertilitetit janë të lidhura kimikisht në formë organike ose, në cdo rast, formojnë një pjesë integrale të materialit. **Ligji nr. 17/2020 “Për produktet plehëruese”, konkretisht nenit 7, pika 1, përcakton qartë se të gjitha produktet plehëruese që prodhohen, importohen e tregtohen për t’u përdorur në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit. Gjithashtu, në reference të nenit 14 të ligjit 17/2020, operatorët ekonomik që veprojnë në fushën e tregtimit të produkteve plehëruese organike duhet që të importojnë vetëm produkte të rregjistruara paraprakisht pranë organeve kompetente. Pra qartazi arrihet në konkluzionin se operatorët ekonomik nuk mund mbajnë në ambientet e tyre magazinuese produkte plehëruese organike, në rastin konkretë “torfë” që kanë prejardhje importi apo që janë prodhuar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të parregjistruara paraprakisht. Ligjvënësi në nenin 17 të ligjit 17/2020, ka përcaktuar qartë se në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm përdorimi i produkteve plehëruese të rregjistruara. Në këtë kuptim Autoriteti Kontraktor nuk mund hyj në marrëdhënie kontraktuale me subjekte të cilat nuk garantojnë paraprakisht përpunueshmërinë e mallit (produkt plehërues organik/torfë) me***

normat teknike dhe ligjore të përcaktuara në aktet rregullatore. Rregjistrimi produkteve plehëruese konformë akteve ligjore në fuqi, përpara importimit, tregtimit dhe përdorimit të tyre, ka si qëllim certifikimin e tyre në lidhje garantimin e shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe përmirësimin e cilësive fiziko-kimike dhe të pjellorisë së tokës.

Gjithashtu vlen të theksohet se prodhimi, importi, vendosja në treg dhe përdorimi i produkteve plehëruese të parregjistruara përbën kundravajtje administrative e cila ndëshkohet me masë administrative në përputhje me shkronjën “ç”, pika 1, neni 30 të ligjit 17/2020.

Per rrjedhojë Autoriteti Kontraktor nuk mundet të marr dhe të vendos në përdorim produkte plehëruese të parregjistruara, pavarësisht garancisë dhe “marrjes së përgjegjësive” së operatorit ekonomik në lidhje me përmbushjen e specifikimeve teknike të mallit të ofertuar, pasi në këtë rast AK do të krijonte kushte për favorizmin e subjekteve tregtare që veprojnë në kundërshtim me ligjin e fushës dhe njëkohësisht do të konsumonte edhe vete shkeljen administrative duke përdorur produkte plehëruese të parregjistruara. Kërkesa për paraqitjen nga ana e operatorëve ekonomik të certifikatës së rregjistrimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, garanton Autoritetin Kontraktor se malli që synohet të prokurohet, përmbushë normat bazë të vendosura nga legjislacioni në fuqi. Ky kriter është vendosur në përputhje me shkronjën “c”, pika 6, neni 40, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, ku është sanksionuar e drejta e Autoritetit Kontraktor për të kërkuar nga operatorët ekonomik dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Në rastin konkretë certifikata e rregjistrimit e lëshuar nga Ministria përgjegjëse për bujqësinë, përmban të dhënat teknike të produktit plehëruar organik, mostrat e të cilat janë nënshtruar paraprakisht analizave laboratorike nga laboratorit i referencës në përputhje me parashikimet e shkronjës “c”, pika 4, neni 9 dhe pikës 1, neni 23, të ligjit 17/2020.

Për sa më lartë, pretendimet e operatorit ekonomik “AME 2020” SHPK nuk qendrojnë.”.

III.2.4. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.5. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

*“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.*

III.2.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se:

*“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.2.7. Në nenin 40, pika 5 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.2.8. Në nenet 1, 2, 3, 5, 7 dhe 12 të Ligjit Nr. 17/2020 “Për produktet plehëruese”, parashikohet si më poshtë:

### **Neni 1 Qëllimi**

*Ky ligj ka për qëllim:*

a) garantimin e shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe mbrojtjen e mjedisit nga përdorimi i produkteve plehëruese;

b) rritjen e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve me elemente ushqyese;

c) përmirësimin e cilësive fiziko-kimike dhe të pjellorisë së tokës..

### **Neni 2 Objekti**

*Ky ligj përcakton rregullat për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, informimin, reklamimin dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me produktet plehëruese, si dhe organizimin e funksionimit e strukturave përkatëse.*

### **Neni 3 Fusha e zbatimit**

*Ky ligj zbatohet për:*

a) produktet plehëruese që regjistrohen, prodhohen, eksportohen, tregtohen, importohen dhe përdoren në Republikën e Shqipërisë;

b) personat fizikë e juridikë që ushtrojnë veprimtari të parashikuara në dispozitat e këtij ligji, si dhe të legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet, vlerësimin e ndikimit në mjedis, lejet e mjedisit e kimikatet.

### **Neni 5 Klasifikimi produkteve plehëruese**

*1. Produktet plehëruese klasifikohen në grupe si më poshtë:*

a) produktet plehëruese inorganike;

b) produktet plehëruese organike; c) produktet plehëruese organo-minerare;

- ç) produktet plehëruese bazuar në elemente ushqyese dytësore; d) produktet plehëruese bazuar në mikroelemente;*
  - dh) produktet plehëruese me veprim specifik (frenuesit, biostimulantët e bimëve);*
  - e) produktet plehëruese të veçanta;*
  - ë) korrektuesit;*
  - f) substratet e kultivimit (rritjes);*
  - g) përmirësuesit e tokës;*
  - gj) materialet organike të destinuara për prodhimin e produkteve plehëruese organo-minerare.*
- 2. Klasifikimi i hollësishëm i produkteve plehëruese të lejuara për regjistrim miratohet me urdhër të ministrit.*

## **Neni 7**

### **Kërkesat që duhet të plotësohen për regjistrimin e produkteve plehëruese**

- 1. Të gjitha produktet plehëruese që prodhohen, importohen e tregtohen për t'u përdorur në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit.*
- 2. Një produkt plehërues mund të regjistrohet, nëse përmbush kërkesat, si më poshtë:*
  - a) produkti plehërues të jetë i miratuar, sipas pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji;*
  - b) lënda ushqyese garanton siguri, cilësi dhe efektshmëri;*
  - c) ekzistojnë metodat e analizave dhe të testimeve;*
  - ç) nuk ndikon negativisht në shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve dhe në mjedis;*
  - d) përmbush të gjitha kërkesat për ambalazhimin, etiketimin dhe magazinimin, sipas dispozitave të këtij ligji;*
  - dh) përmbush kufijtë e tolerancës.*

## **Neni 12**

### **Dokumenti i regjistrimit të produktit plehërues**

- 1. Dokumenti i regjistrimit të produktit plehërues përmban certifikatën e regjistrimit dhe etiketën. Certifikata e regjistrimit lëshohet nga kryetari i komisionit, jo më vonë se 5 ditë nga data e mbledhjes së komisionit dhe shoqërohet me etiketë.*

*Dokumenti i regjistrimit mbahet në tri kopje origjinale, nga të cilat, njëra mbahet në arkivin e ministrisë, njëra në SPPP, ndërsa kopja tjetër i jepet aplikantit.*
- 2. Në certifikatën e regjistrimit, e cila plotësohet në gjuhën shqipe, jepen të dhënat si më poshtë:*
  - a) emri tregtar;*
  - b) numri dhe data e regjistrimit;*
  - c) emri i aplikantit dhe adresa e tij;*
  - ç) emri i prodhuesit dhe adresa e tij;*
  - d) emri i importuesit në Shqipëri dhe adresa e tij;*
  - dh) grupi;*
  - e) pamja e jashtme e tij;*
  - ë) përmbajtja;*



- f) afati i vlefshmërisë;
- g) mënyra e përdorimit (me shënimin: *Shih etiketën bashkëlidhur!*).
3. Në etiketën e produktit plehërues jepen të dhënat si më poshtë:
- a) emri tregtar;
- b) numri dhe data e regjistrimit;
- c) emri i aplikantit dhe adresa e tij;
- ç) emri i prodhuesit dhe adresa e tij;
- d) emri i importuesit në Shqipëri dhe adresa e tij;
- dh) emri i pakuesit, nëse kryhet paketimi në Shqipëri dhe adresa e tij;
- e) emri i grupit, i cili shkruhet me shkronja të mëdha;
- ë) pamja e jashtme e tij;
- f) përmbajtja e përbërësve të produktit plehërues, përfshirë edhe përmbajtjen e elementeve të përshkruara me fjalë e simbole kimike dhe në lidhje me ushqyesit e format e tretshme;
- g) numri i serisë;
- gj) mënyra e përdorimit;
- h) sasia neto e produktit plehërues, që ndodhet në ambalazhin parësor;
- i) afati i ruajtjes;
- j) kushtet e ruajtjes;
- k) udhëzimet për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, sigurinë e mbrojtjen e mjedisit.
- Përmbajtja e etiketës duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe në përputhje me rregullat e parashikuara në pikën 4, të nenit 17, të këtij ligji.*

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin specifik për sa i përket rastit konkret, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Refruar sa më sipër, Komisioni gjykon, se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me "Certifikatë e Regjistrimit të lëshuar nga Ministria e Buqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit" është në përputhje me objektin e kontratës, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Ligji Nr. 17/2020 "*Për produktet plehëruese*" në nenin 7, pika 1 të tij, parashikon shprehimisht, se të gjitha produktet plehëruese që prodhohen, importohen e tregtohen për t'u përdorur në territorin e Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohen procedurës së regjistrimit, ndërkohë që në nenin 12, pika 1 të po këtij ligji, përcaktohet, se dokumenti i regjistrimit të produktit plehërues përmban certifikatën e regjistrimit dhe etiketën dhe se certifikata e

regjistrimit lëshohet nga kryetari i komisionit, jo më vonë se 5 ditë nga data e mbledhjes së komisionit dhe shoqërohet me etiketë.

Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson, se Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit “Certifikatë e Regjistrimit të lëshuar nga Ministria e Buqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” për produktin “Torfë” objekt-prokurimi, nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se dokumenti i kërkuar mund të sigurohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me mallra, për të cilat kanë për detyrë bazuar dhe mbi ligjin nr. 17/2020 “Për produktet plehëruese”, të bëjnë regjistrimin e tyre pranë autoritetve përkatëse dhe pajisjen me certifikatat përkatëse nga këto autoritete.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, për sa i përket modifikimit të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, si në vijim: *“Gjithashtu, përcaktimi i parametrave të torfës - Pamja e jashtme (gjendja fizike dhe ngjyra).*

*Përzierje e ngurtë, me ngjyrë biond dhe të errët.*

*- Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lëndë organike (MO), 80%, Ushqyes Makro dhe Mikroushqyes 1.5 kg/m<sup>3</sup>, Karbonat kalciumi (CaCO<sub>3</sub>) 3-3.5 kg/m<sup>3</sup>.*

*Ose*

*- Pamja e jashtme (gjendja fizike dhe ngjyra): Përzierje e ngurtë me ngjyrë.*

*- Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë:*

*Lëndë organike (MO): 80%; Ushqyes makro dhe mikroushqyes: 1.5 kg/m<sup>3</sup>; Karbonat kalciumi (CaCO<sub>3</sub>): 2-2.5 kg/m<sup>3</sup>*

*Ky përcaktim i bere nga AK i parametrave/karakteristikave të artikullit, referon në një prodhues të caktuar, dhe nuk le mundësinë për ofrimin e disa artikujve të tjerë ekuivalente është i ekzagjeruar, dhe tejkalon natyrën dhe përmasat e kontratës.*

*Gjithashtu, përcaktimi i këtij kriteri do të ndikonte në kufizimin e konkurrencës dhe nuk do të stimulonte pjesëmarrjen e biznesit të vogël në procedurën e prokurimit objekt ankimi.”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1 Në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 7 “**FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

*“2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë prodhues ose furnizues/tregtues i autorizuar i torfës profesionale. Për kete duhet te paraqese:*

a) Licencë prodhimi ose kontratë furnizimi me torfë profesionale

b) Certifikatë e Regjistrimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe duhet te permbushë karakteristikat e mëposhtme:

- Pamja e jashtme (gjendja fizike dhe ngjyra) Përzierje e ngurtë, me ngjyrë biond dhe të errët.
- Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lëndë organike (MO), 80%, Ushqyes Makro dhe Mikroushqyes 1.5kg/m<sup>3</sup>, Karbonat kalciumi (CaCO<sub>3</sub>)3-3.5 kg/m<sup>3</sup>.  
Ose
- Pamja e jashtme (gjendja fizike dhe ngjyra): Përzierje e ngurtë me ngjyrë kafe të errët.
- Përmbajtja (në %) e torfës duhet të jetë: Lëndë organike (MO): 80% ; Ushqyes makro dhe mikroushqyes: 1.5kg/m<sup>3</sup> : Karbonat kalciumi (CaCO<sub>3</sub>) : 2-2.5 kg/m<sup>3</sup>.”.

III.3.1 Në shtojcën 7 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar specifikimet teknike të produkteve objekt-prokurimi, si më poshtë:

#### **Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

#### **Skicimet, parametrat teknik etj.:**

- **Torfë importi (substrat me mikroelement ushqyes, paketim 70 litër)**

1. Të jetë ambalazhuar dhe shoqëruar me fletë udhëzuesin e përdorimit përkatës.

2. Të ketë të shkruar mbi ambalazh emërtimin, muajin dhe vitin e skadencës, sasinë e ambalazhuar, elementet përbërës, vendin e prodhimit.

4. Ambalazhi të siguroj ruajtjen në kushte optimale dhe depërtimin e lagështirës.  
 5. Specifikimet teknike dhe disa tregues të përbërjes së torfës i paraqesim më poshtë:

1. Produkti: Substrati ProfiMix 2b,
  2. Struktura: 60% 0-20% e bardhë A torfë  
40 % 0-10 e zezë C torfë
  3. Përmbajtja e lagështisë: 40-60%
  4. Acideti PH (CaCl): 5,5-6,5
  5. Përmbajtje NPK: 14
  6. Komponentët plotësues: Argjilë Radigen
  7. Agjentët e lagështirës: Flba Zorb
  8. Ambalazhuar në thasë me peshën: 70 litra
- **Torfë (e thjeshtë)**
1. Përmbajtja e lagështisë: 40 %
  2. Të jetë i pastër nga mbeturinat.
  3. Të jetë e frezuar dhe e situar.
  4. Të jetë e ambalazhuar në thasë 50 kg.

- **Plehu organi**

1. Të jetë pleh organik prodhuar nga stallat e bagëtive të imta.
2. Të jetë pleh organik i dekompozuar mbi dy vjet dhe i mbuluar me dhe.
3. Të jetë i pastër nga mbeturina (copa drurësh, degësh, gurë, etj).
4. Të jetë ambalazhuar në thasë: 25 k

- **Humus pylli**

1. Të jetë grumbulluar në pyje fletorë nën shtresën e lëgushës 10 cm.
2. Të jetë i pastër nga mbeturinat (copa drurësh, degësh, gurë, etj).
3. Të jetë i situar.
4. Të jetë ambalazhuar në thasë 25 kg

- **Plehra kimike**

1. Të jenë të ambalazuara dhe të shoqëruar me fletë udhëzuesin e përdorimit përkatës.
2. Të kenë të shkruar mbi ambalazh emërtimin e plehut kimik, muajin dhe vitin e skadencës, sasinë e plehut kimik të ambalazhuar, elementet përbërës, vendin e prodhimit.
3. Plehurat kimike të jenë të ambalazhuar sipas llojit dhe përbërjes e gjendjes;
  - për plehurat kimik në gjendje kokrrizore, të jetë në ambalazhe plastike ose letër kundra ujit
  - për plehurat kimike në gjendje pluhur, të jenë në ambalazh letre kundra ujit
4. Ambalazhi të siguroj ruajtjen në kushte optimale dhe depërtimin e lagështirës.
5. Specifikimet teknike dhe disa tregues të përbërjes së pesticideve i paraqesim më poshtë:

**Produkti: Nitrofoska**

Produkti	N	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	K <sub>2</sub> O	MgO	SO <sub>3</sub>	B	Zn*	Mn*	Fe	Cu*	Mo
Nitrofoska <sup>®</sup> special	12	12	17	2	20	0,02	0,01	-	-	-	-

**Produkti: NPK**

Produkti	N	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	K <sub>2</sub> O
NPK	15	15	15

**Produkti: Nitrat Amoni**

Përmbajtja	Rezultati	Metoda
Përmbajtja e azotit	34.63%	EC 2003/2003-M2
Lagështira	0.39%	AOAC 950.1-2005
Granulometria 1.0-4.0 mm	99.20%	EC 2003/2003M5

**Produkti: DAP**

Produkti	N	P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	K <sub>2</sub> O
DAP (NH <sub>4</sub> ) <sub>2</sub> HPO <sub>4</sub> (s)	18	46	0

III.3.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues dhe specifikimeve teknike, si më poshtë:

**“Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, licencat e mësipërme që kërkohen janë të lëshuara nga QKL dhe licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit, secila prej tyre është e përfshirë në fushën e gjelbërimit dhe kërkimi i tyre që të zotërohen nga OE pjesëmarrës në procedurë tregon kualifikim dhe cilësi.

**II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III.3.3. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 906/14 prot, datë 04.07.2023, drejtuar ankimuesit ka argumentuar si në vijim:

*“II. Në lidhje me kundërshtimin e paraqitur nga OE “AME 2020” SHPK sa i takon parametrave të vendosur për produktin plehërues organikë (torfë importi me mikroelementë) sqarojmë se: Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar edhe gjatë viteve paraardhëse procedura prokurimi që kanë patur si objekt ndër të tjera edhe blerjen e torfës së importit me parametra të njëjtë (pamja e jashtme, dhe përmbajtja në % e torfës sa i takon lëndës organike dhe elementëve ushqyes makro dhe mirko) me torfën që kërkohet të sigurohet nëpërmjet kësaj procedure prokurimi. Nga aplikimi në praktikë e kësaj lloji torfe është konstatuar se lënda ushqyese në të tilla parametra ka treguar efektshmëri dhe efikasitet në rritjen, cilësinë dhe jetëgjatësinë e bimësisë (fidanë dhe lule) që prodhohet në serat që administrohen nga Autoritetit Kontraktor. Përcaktimi i specifikimeve teknike të mallit që kërkohet të prokurohet është bazuar në shkronjën “b”, pika 34, neni 4 dhe pika 1, neni 36, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”. Përcaktimi i parametrave të mallit (torfës) që do të prokurohet ka si synim qartësimin e karakteristikave të kësaj të fundit me qëllim shmangien e keq interpretimeve nga ana e operatorëve ekonomik të interesuar por edhe garantimin e cilësisë së produktit që do të prokurohet. Qartazi parametrat e torfës që janë përcaktuar në DST, lidhen vetëm me raportin e elementëve ushqyes që duhet të përmbajë ky lloj produkti. Duke qenë se parametrat e përcaktuar në vetvete janë elemente ushqyes që gjenden në materialet organike me natyrë shtazore ose bimore, nuk kufizohet spektri i prodhuesve të këtij produkti dhe për rrjedhojë nuk krijohen kufizime për operatorët ekonomike që veprojnë konform legjislacionit shqiptar në fuqi dhe që kanë interes të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi.*

*Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik “AME 2020” SHPK nuk qëndrojnë.*

III.3.4. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është*

*ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.3.5. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

*“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.*

III.3.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se:

*“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.3.7. Në nenin 74, pika 1 “Dokumentet e tenderit”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoriteti ose enti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike.”.*

III.3.8. Në nenin 40, pika 2 dhe 5 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme*

përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.3.9. Në nenin 15 “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit ” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.

2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:

- njoftimin paraprak të informacionit/njoftimin periodik të informacionit;
- njoftimin e kontratës;
- ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);
- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
- formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;
- deklaratën e konfliktit të interesit;
- deklaratën e informacionit konfidencial;
- formularin e ofertës ekonomike;
- sigurimin e ofertës;
- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- njoftimin e fituesit;
- formularin e ankesës;
- modelin e marrëveshjes kuadër;
- njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;
- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;
- sigurimin e kontratës;
- njoftimin e lidhjes së kontratës;
- njoftimin e anulimit të procedurës.

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:



*a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:*

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

*b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:*

- specifikimet teknike;
- grafikun e livrimit
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

*c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:*

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.”.

III.3.10. Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, vëren, se është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Nisur nga parashtrimet e operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me pretendimet mbi modifikimin e kriterit kualifikues të pikës 2.3.3/b të përcaktuar në Shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, për sa i përket specifikimeve teknike të torfës, të cilat duhet të jenë të pasqyruara në Certifikatën e Regjistrimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të hartuara dhe të publikuara nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se specifikimet teknike të torfës janë përcaktuar nga ana e entit prokures në Shtojcën 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” sipas parashikimeve të nenit 15 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndërkohë që në kundërshtim me përcaktimet e kësaj dispozite në Shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” autoriteti kontraktor ka publikuar specifikime teknike të torfës të ndryshme nga ato të publikuara në Shtojcën 5 të po këtyre dokumentave.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kërkesa e ankimuesit është e drejtë dhe mirëargumentuar, duke vënë në dukje parregullsi në hartimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në përcaktimin e kërkesave për kualifikim duhet të ketë parasysh që ato t’i shërbejnë dhe të jenë në funksion të qëllimit të objektit të prokurimit, duke lehtësuar punën e operatorëve ekonomikë në përgatitjen e ofertave të tyre.

Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor që Certifikata e Regjistrimit e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të pasqyrojë specifikimet teknike të torfës të dhëna në kriterit kualifikues të pikës 2.3.3/b të përcaktuar në Shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, është një kërkesë e tepruar dhe që krijon konfuzion e nuk i shërben objektit të prokurimit, pasi specifikimet teknike të torfës janë përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në shtojcën përkatëse dhe konkretisht në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit.

Këto specifikime duhet të ishin pasqyruar në Shtojcën 5 të këtyre dokumenteve. Autoriteti Kontraktor duhet të modifikojë kriterin kualifikues të pikës 2.3.3/b të përcaktuar në Shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, duke hequr specifikimet teknike të torfës objekt-prokurimi, si një kërkesë e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me parimet dhe rregullat e prokurimit publik.

Referuar arsytimit sipërcituar, pretendimi e operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, për sa i përket modifikimit të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në lidhje me kapacitetin mbajtës të mjeteve të transportit, si në vijim: *“Kundërshtojmë kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, pasi ky përcaktim i bërë nga ana e AK është në shkelje të ligjit dhe kufizon konkurrencën dhe pjesëmarrjen e lirë, pasi kërkesa e AK nuk justifikon numrin, kapacitetin dhe mënyrën e disponimit të tyre. Gjithashtu, referuar zërave të preventivit dhe sasive, nuk është i justifikueshem disponimi i 4 kamionçinave, por mjafton disponimi i vetëm 2 kamionçinave me tonazh deri në 1 ton, pasi ky kriter është i ekzagjeruar, dhe tejkalon natyrën dhe përmasat e kontratës.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1 Në pikën 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

*“2.3.6. Të ketë në pronësi ose me qira mjetet për transportin e mallit objekt-prokurimi si më poshtë:*

- *Kamionçina, 2 (dy) copë , me kapacitet mbajtës mbi 1.3 ton, në pronësi ose me qira.*
- *Kamionçina, 2 (dy) copë , me kapacitet mbajtës nën 1 ton, në pronësi ose me qira.*
- *Kamion me vinç, 1 (një) copë , me kapacitet mbajtës jo më pak se 3 ton, në pronësi ose me qira.*
- *Pirun, 1(një) cope, në pronësi ose me qira*

*Të pajisura me dokumentet si më poshtë:*

- *Certifikatë pronësie ose kontrate qiraje e lidhur tek noteri, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- *Leje qarkullimi*
- *Certifikatën e kontrollit teknik*

- Siguracionin e mjetit

Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie original ose kopje të noterizuar (shitblerje ose kontrata dhurimi).

Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (original ose kopje e noterizuar). Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).

Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme) me foto.

Për mjetet me qira duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme) dhe foto. Duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Ky kriter do të përmbushet nga Operatori Ekonomik me anë të formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.”

III.4.1 Në shtojcën 6 “**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar sasi të dhe afati i lëvrimit të produkteve objekt-prokurimi, si më poshtë:

**Shtojca 6**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

<b>Nr.</b>	<b>Emri Shqip</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
<b>A</b>	<b>. Blerje Pleh organik+humus</b>		
<b>1</b>	Torf importi (70 lit)	litër	120 000
<b>2</b>	Torfë	Kg	80 000
<b>3</b>	Pleh organic	Kg	90 000
<b>4</b>	Humus	Kg	150 000
<b>5</b>	Plehra kimik kristalor	Kv	10
<b>6</b>	NPK	Kv	24

7	Dap	Kv	25
8	Nitrat	Kv	25

**Afatet e lëvrimit: 30 (tridhjetë) ditë nga lidhja e kontratës**

III.4.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

**“Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i mjeteve në pronësi / qira / kontratë furnizimi është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambientin ku do të magazinohet nga autoriteti kontraktor. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.”.

III.4.3. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 906/14 prot, datë 04.07.2023, drejtuar ankimuesit ka argumentuar si në vijim:

**“III.** Në lidhje me kundërshtimin e paraqitur nga OE “AME 2020” SHPK sa i takon kriterit të pasjes në pronësi ose me qira të mjeteve motorrike si dhe kërkesës për paraqitjen e certifikatës së pronësisë së mjeteve, sqarojmë se: Nisur nga natyra e mallit që do të prokurohet si dhe nga afati i lëvrimit të përcaktuar në shtojcën 6, konkludohet se numri i automjeteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor nuk është në përputhje me sasinë/volumin e mallit që do të prokurohet. Konkretisht kërkesa për disponimin i 4 kamionçinave nga ana e operatorëve ekonomik, respektivisht 2 me kapacitete mbajtës mbi 1.3 ton dhe 2 me kapacitet mbajtës nën 1 ton, nuk është në proporcion me natyrën e kontratës. Ky kriter duhet të rishikohet nga ana e Autoritetit Kontraktor duke ulur numrin e mjeteve që duhet të disponojnë operatorët ekonomik.

Sa i takon kërkesës për disponimin e një kamioni me vinç me kapacitete mbajtës deri në 3 ton dhe të një piruni, vlerësojmë se kjo kërkesë nuk është në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e mallit dhe për këtë arsye duhet të rishikohet nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Kjo pike ndryshohet si më poshtë:

2.3.6. Të ketë në pronësi ose me qira mjetet për transportin e mallit objekt prokurimi si më poshtë:

- Kamionçina, 2 (dy) copë , me kapacitet mbajtës mbi 1.3 ton, në pronësi ose me qira.
- Kamion me vinç, 1 (një) copë , me kapacitet mbajtës jo më pak se 3 ton, në pronësi ose me qira.

Të pajisura me dokumentet si më poshtë:

- Certifikatë pronësie ose Leje qarkullimi ose kontrate qiraje e lidhur tek noteri, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Certifikatën e kontrollit teknik
- Siguracionin e mjetit

Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose leje qarkullimi ose kopje të noterizuar (shitblerje ose kontrata dhurimi).

Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar) ose leje qarkullimi. Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).

Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme) me foto.

Për mjetet me qira duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme) dhe foto. Duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.”

III.4.4. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.4.5. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.4.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.4.7. Në nenin 40, pika 5/ç “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.4.8. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (mjetet e transportit), në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës objekt-prokurimi. Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin, se duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.”, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse, si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kërkesën e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e 2 (dy) kamionçinave me kapacitet mbajtës mbi 1.3 ton, referuar objektit dhe volumit të kontratës objekt-prokurimi, sasive dhe karakteristikave të disa prej mallrave të parashikuara në preventiv, Komisioni gjykon, se kjo kërkesë nuk është e ekzagjeruar dhe kufizuese, si dhe është e justifikuar nga autoriteti kontraktor, pasi disa prej mallrave objekt-prokurimi, kërkojnë kapacitete transportuese të konsiderueshme. Akoma më tej, Komisioni vëren, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar dy mënyra disponimi/posedimi të këtyre mjeteve, duke iu lënë mundësinë operatorëve ekonomik të interesuar të përmbushin këtë kriter edhe nëpërmjet kontratës së qirasë. Në këto kushte, Komisioni gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor është e justifikuar dhe në përputhje me volumin e kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “A.M.E 2020” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-73401-06-22-2023, me objekt “Blerje pleh organik, humus trofe dhe pleh kimik”, me fond limit 8,080,000 (tetë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.07.2023, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
  2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
  3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
  4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “A.M.E 2020” ShPK.
  6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**